




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RTK 1
Lorik Arifaj
Drejtor
Prishtinë



VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2021/27- Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
RTK 1 (Palë përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, përmes të cilit përcaktohet sjellja e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin e VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave me datën 18 tetor 2019 mori Vendim që ta dënojë Palën përgjegjëse me Vërejtje për gjetjen në shkelje të nenit 49, paragrafi 6, të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
3. KPM, me datën 26 janar 2021 i ka dërguar Palës përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, me qëllim që t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës dhe heshtjes zgjedhore gjatë Zgjedhjeve të Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
4. KPM me datën 1 shkurt 2021 elektronikisht i ka njoftuar të gjithë të licencuarit e KPM-së se duke u bazuar në mandatin ligjor është duke i monitoruar mediat për pajtueshmërinë e tyre me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, duke ua rikujtuar se është i ndaluar sponsorizimi dhe vendosja e produkteve në emisionet e lajmeve dhe programet për çështje aktuale me interes për publikun.
5. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, ka bërë monitorimin e këtij ofruesit të shërbimeve mediale në datat 3 dhe 4 shkurt 2021 dhe në bazë të Raportit të monitorimit ka gjetur se Pala përgjegjëse ka transmetuar spote politike të cilat nuk janë identifikuar, duke vepruar në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 6, të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

6. KPM me datën 5 shkurt 2021 i ka dërguar Njoftim për shkelje Palës përgjegjëse dhe e ka njoftuar për shkeljet e bëra, si dhe e ka uchëzuar që të veprojë në pajtueshmëri me Kreun e VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.
7. KPM pas dërgimit të Njoftimit për shkelje ka bërë edhe një monitorim të Palës përgjegjëse për datën 7 shkurt 2020, për të vlerësuar ardhjen në pajtueshmëri me Ligjin Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave. Në bazë të Raportit të monitorimit të datës 8 shkurt 2020 është gjetur se Pala përgjegjëse vazhdon të veprojë në kundërshtim me Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale.

Analiza ligjore

8. Komisioni i Pavarur i Mediave, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenit 12, paragrafi 1 të Rregullores për Komunikimet Komerciale KPM 2017/07.
9. KPM konstaton se edhe pse Pala përgjegjëse është njoftuar me kohë për respektim të Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhje, Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, i është dërguar Udhëzuesi me qëllim që t'ju ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore, sërisht është gjetur në shkelje. KPM bazuar në Raportin e monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore ka transmetuar spote politike të cilat nuk janë identifikuar nëse janë me pagesë (Partia Demokratike e Kosovës) apo pa pagesë (Partia Demokratike e Kosovës, Nisma Social Demokratike, Lidhja Demokratike e Kosovës), si dhe ka transmetuar spote politike të cilat janë identifikuar si me pagesë por nuk janë identifikuar se nga kush janë të paguara apo të sponsorizuara, duke vepruar në shkelje të nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton se:

“Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin “përgjegjës për të”.

10. KPM bazuar në Raportin e dytë të monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse në emisionin për çështje aktuale “Analizë zgjedhjet 2021” ka transmetuar reklamim me ekran të ndarë, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 12, paragrafi 1 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale, i cili përcakton se:

“Reklamimi me ekran të ndarë nuk duhet të jetë i tepërt në atë mënyrë që do t'ua pamundësonte shikuesve të vazhdojnë të shikojnë përmbajtjen editoriale dhe nuk duhet të përdoret në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale. Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me orarin dhe kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshoppingut do të zbatohen për reklamimin me ekran të ndarë.”


11. KPM si rrethanë rëndësuese për Palën përgjegjëse e ka konsideruar edhe dështimin e Palës përgjegjëse për të vepruar në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet edhe në të kaluarën, konkretisht në zgjedhjet e vitit 2019.
12. Komisioni, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, konstaton se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenit 12, paragrafi 1 të Rregullores për Komunikimet Komerciale KPM 2017/07.

Vendim

13. Pala Përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumën prej pesë mijë (5.000) euro në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 12, paragrafi 1 të Rregullores për Komunikimet Komerciale KPM 2017/07.

E drejta për ankesë

14. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
15. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Xhevat LATIFI
Kryetar



11.02.2021

Datë